



Para-lajmërim i Ftesës për Aplikimin e ardhshëm

(Raundi XIII i Young Cell Scheme, Programi i BE-së për bursa post-diplomike)

Ky është një para-lajmërim për të informuar lidhur me hapjen e ardhshme të ftesës për aplikim për Raundin XIII të Young Cell Scheme, programi i BE-së për bursa post-diplomike. Tani nuk kërkohet asnjë veprim nga aplikantët potencial.

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe **Zyra e Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës**, paralajmërojnë hapjen e radhës të konkursit për Raundin e 13-të, të aplikimit për Young Cell Scheme, programi i BE-së për bursa post-diplomike për qytetarët e Kosovës. Kandidatëve të suksesshëm do t'iu ofrohet mundësia të aplikojnë për Programi Master një ose dy vjeçare në universitete të shteteve anëtare të BE-së. Programi i bursave, gjuha e punës e së cilit është vetëm gjuha angleze.

Kjo ftesë do të jetë e hapur për publikun e përgjithshëm dhe shërbyesit civil (detajet dhe rregullat e mëtejshme do të publikohen në Ftesën për Aplikim) në fushat e mëposhtme:

- ◇ Juridik (përfshirë ligjin e BE-së)
- ◇ Administratë Publike dhe Qeverisje e Mirë (përfshirë Menaxhimin e Burimeve Njerëzore)
- ◇ Ekonomi, Financa, Menaxhment (përfshirë Menaxhimin e Burimeve Njerëzore)
- ◇ Energji, Mjedis dhe Ndryshimet Klimatike, Transport
- ◇ Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacia (përfshirë mbrojtjen dhe sigurinë)
- ◇ Sektorë tjerë sipas kërkesës së Administratës Publike të Kosovës

Të drejtë konkurimi kanë aplikantët të cilët janë:

- ◇ **Banorë të Kosovës** me pasaportë të vlefshme të Kosovës apo me letërnjoftim të lëshuar nga Autoritetet Kosovare ose ata të cilët ofrojnë dëshmitë e lindjes dhe të vendbanimit në Kosovë (**vini re: çertifikata e lindjes dhe çertifikata e vendbanimit** të dyja kërkohen në rastet kur në asnjë mënyrë nuk mund të sigurohet letërnjoftimi).
- ◇ Të diplomuarit në njërin nga fushat e studimeve që iu përkasin sektorëve
- ◇ Flasin rrjedhshëm gjuhën angleze dhe shqipe apo serbe.
- ◇ Janë lindur më 1 janar 1988 apo më vonë

Bursat do të mbulojnë shpenzimet, si në vijm:

- ◇ Shpenzimet e aplikimit dhe të shkollimit
- ◇ Shpenzimet e jetesës
- ◇ Shpenzimet e vizës & sigurimin shëndetësor
- ◇ Nje bilete e udhëtimit kthyes
- ◇ Trajnimi përgatitor i gjuhës angleze për- dhe shpenzimet e testit të gjuhës angleze IELTS (në rast se studimet do të bëhen në një gjuhë tjetër të BE-së, testet e tjera të kërkuara të gjuhës gjithashtu mund të rimbursohen)

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të zotohen të:

- ◇ Të jenë në dispozicion për t'iu nënshtruar trajnimit/praktikës nga shkurti 2023 e tutje dhe për të lëvizur jashtë vendit nga gushti 2023 deri në përfundimin e përfundimit të parashikuar të studimeve.
- ◇ Punojnë për Administratën Publike të Kosovës si praktikant për së paku 4 muaj para nisjes (përveç shërbyesve civil të cilët veç janë të punësuar në Administratën Publike në Kosovë)
- ◇ Ndjekin Programin e Trajnimit të gjuhës në kuadër të YCS (ku është e nevojshme)
- ◇ Ndjekin dhe kryejnë studimet e zgjedhura post-diplomike
- ◇ Përbushin obligimin e punësimit apo ripunësimit (nëse janë shërbyes civil) të pandërprerë trevjeçar në Administratën Publike të Kosovës (përfshirë punësimin nëpër komuna dhe qeveri lokale), pas kthimit.





Përzgjedhja do të zhvillohet në tri faza dhe përfshinë:

- ◇ Para-përzgjedhja bazuar në kriteret administrative dhe të përzgjedhshmërisë
- ◇ Testet me shkrim (i njohurisë së gjuhës angleze, njohuri të përgjithshme të shërbimit civil dhe/ose njohuri të sektorit dhe vlerësimi verbal & numerik)
- ◇ Intervistë nga paneli i akademikëve evropianë. Përfaqësuesit e ZBE dhe të QK do të marrin pjesë në panel si vëzhgues

E gjithë procedura e përzgjedhjes do të zbatohet në përputhje me Rregulloren (MAP) Nr. 01/2019 për Përfituesit e Skemave të Bursave.

Femrat dhe përfaqësuesit e minoriteteve fuqimisht inkurajohen të aplikojnë. Formularët e aplikimit dhe dokumentet tjera përcjellëse do të jenë të disponueshme për shkarkim nga interneti, në web faqen vijuese <https://ycskosovo.org> Aty do të publikohen gjithashtu informatat shtesë mbi rregullat e skemës, procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes.

Ky është vetëm para-lajmërim për të informuar aplikantët potencial për hapjen e ardhshme të ftesës për aplikim. Aplikimi ende **nuk** është hapur.

Për më shumë informata <https://ycskosovo.org>

Lidhuni me YCS ne Mediat Sociale



Young Cell Scheme
Scholarship
Programme



Youngcellscheme



Young Cell Scheme



Young Cell Scheme

